

QEMAL HAXHIHASANI

TË DHËNA BIBLIOGRAFIKE RRETH TRADITËS POPULLORE PËR SKËNDERBENË

Me të dhënat bibliografike që jepen më poshtë nuk mund të jepet një bibliografi e plotë e materialeve dhe punimeve të botuara rreth traditës popullore për heronë tonë kombëtar, por më shumë një kontribut drejt këtij qëllimi. Këto shënime janë më tepër të dhëna të grumbulluara gjatë shfrytëzimit të letërsisë për studimet e përgatitura në kuadrin e jubileut të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Ato nuk paraqesin pra një punë kërkimore sistematike për hartimin e një bibliografie të plotë e të hollësishme. Ne jemi përpjekur të konsultojmë drejtpërsëdrejti letërsinë përkatëse dhe të bëjmë një vjelje të rregullt të materialeve që nevojiteshin për këtë bibliografi. Kur nuk kemi pasur mundësi të bëjmë një punë të tillë nga mungesa e veprave etj., jemi detyruar të paraqesim vetëm informacionin bibliografik me shpresë që në një ribotim të bëjmë plotësimet dhe saktësimet e duhura. Në këto shënime kemi përfshirë edhe botimet e vitit vijues (botimet që kemi mundur të kapim deri në kohën e përgatitjes së këtyre shënimeve), meqenëse gjatë këtij viti jubilar janë botuar mjaft materiale të rëndësishme.

1 (1508-1510)

Barletius, Marinus, Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum Principis. Romae, 1508-1510(?). / Barleti në veprën e tij monumentale, sjell të dhëna me shumë interes edhe në drejtim të fillimeve të traditës popullore rreth Sk. Që në parathënje vihet re se autori ynë, duke mbledhur kujtimet rreth luftërave dhe fakteve të tjera historike nga njerëz që kishin marrë pjesë drejtpërsëdrejti në këto ngjarje, kish dëgjuar edhe gjëra që i përkisnin traditës (f. 48) 1. N. Jorga, F. Pali etj. thonë se Barleti ka shfrytëzuar edhe traditën popullore në hartimin e veprës së tij (shih nr. 40,59).

Në f. 50 e 51 jepen tri legjenda për lindjen e heroit: a) «Thonë pra se, kur e ëma mbeti me barrë me të (Sk.), pa në ëndërr se lindi një dragua aq të madh, sa që mbulonte gati gjithë Epirin, kokën e shtrinte ndërmjet kufijvet të turqvet, të cilët i përpinte me gërmazin e vet të gjaksosur...» b) «Një shenjë tjetër krenarie luftarake shumë më e bukur dhe më e ndritur u pa në krahun e djathtë të fëmijës; një shpatë e shkruar me një mënyrë që dukej si t'ish bërë me dorë»; c) «Më vonë fëmija, me një herë, sa po ja lejoi moshë, zvarrisej drejt armëvet dhe shigjetavet dhe me këto stërvitje fillestare të moshës së njomë ai jepte prova të tilla sa që kushdo i shihte qartë shënjat e trimërisë së ardhëshme».

Të dhëna për këngët, vallet e lodrat: f. 113, 169, 216, 255, 282, 283, 371, 377, 397, 411.

1) Numrat e faqeve dhe citimet epen sipas përkthimit shqip *Historia e Sk.* Tiranë, 1964 (shih Nr. 97)

Me interes për zakonet e kohës f. 296, 332, 333, 337, 338, 348, 349, 357.
(Shih Nr. 97).

2 (1556)

Sabellici, M. Antonii, *Historiae Rerum Venetarum*. Basilae 1556². / Në f. 922-923 të këtij vëllimi gjejmë këtë shënim të rëndësishëm, që dëshmon për lartësimin e figurës së heroit në këngë madhështore menjëherë pas vdekjes: ...«pas vdekjes së tij (Sk.) populli, i mahnitur nga adhurimi i lartë i këtij burri, sikur të shikonte tek ai diçka që kalonte mbi mundësitë njerëzore, e lartësonte kujtimin e princit të dashur me këngë solemne. Më kanë treguar burra të denjë për t'u besuar se mu në mes të zjarrit të luftës, kur gjithçka shungullonte nga armët e barbarve (turqve), grumbuj vajzash (shqipëtare) e kishin zakon të mblihdeshin javë për javë në sheshe (kryqëzime rrugash) të qyteteve ku ai kish sunduar dhe të këndonin lavditë e princit të tyre të vdekur, ashtu siç bënin edhe të vjetrit në gostitë e heronjve të mëdhenj.»

3 (1584)

Franco, Demetrio, *Gli illustri et gloriosi gesti, et vittoriose imprese, fatte contra turchi dal Sign. D. Giorgio Castriotto, detto Scanderbeg, prencipe d'Epirro*. Vinegia 1584. / f. 83 flet për vajtimin e princërve mbi Sk. e vdekur (Noli HSK 1921 f. 267, 268 shton «sipas mënyrës shqiptare»); f. 85 marrja e kockave të Sk. dhe mbajtja e tyre si hajmali nga turqit.

4 (1610)

Bizzi, Marino, *Relazione dell'arcivescovo d'Antivari M.B. diretta al Papa Paolo V° in merito alla visita da lui svolta nelle diocesi d'Albania e di Serbia*. Anno 1610. / f. 86 e origjinalit:

«...Në kishën e sipërthanun (Lezhë) thonë se ka qenë varrosë i famëshmi Aleksandër Kastrioti, i quejtun me emën tjetër Skanderbeg, i cili u da në shenj me shumë luftime të vlerata kundër turqve, të cilat, të qituna në vargje, këndohen n'atë gjuhë prej të gjithë shqiptarëve, edhe në praninë e turqve.» (Shih nr. 92)

5 (1621)

Budi, Pietro, *Lettera di Pietro Budi, vescovo nominato di Sappa, diretta al cardinale Gozzadino in merito alla possibilità dell'organizzazione della guerra in Albania e nel resto dei Balcani Roma, 15 settembre 1621*. / f. 84 «Ka n'anë tjetër, nga kufitë e Maqedhonisë e të Bullgarisë, popuj të tjerë që quhen *viset e Skanderbeut* dmth Matja, Benda, Kurbin, Tamadheja e Çermenika, të vendosun ndër malësitë përmbi Krujë dhe Elbasan, megjithëse të përziem me turq (myslimanë), por pjesa ma e madhe janë të krishtenë, njerëz jo ma pak të fortë dhe luftarakë, e të gjithë me armët e veta (që kapin) në numrin e pesë-mijë luftarëve.» (Shih nr. 88 e 92)

6 (1636)

Blancus, Franciscus, *Georgius Castriottus Epiensis vulgò Scanderbegh, Epirotarum Princeps fortissimus, ac inuictissimus, Suis, & Patriae restitutus. Venetiis*,

2) Botimi i parë i kësaj vepre është bërë më 1487.

Typis Marci Ginammi, 1636. / f. 71 e origjinalit (f. 73 e përkthimit shqip *Skënderbeu* (Apollogji) Tiranë 1957): ...«vazhdimisht gjer në ditët e sotme bashkëkombasit tanë flasin për të (Sk.) dhe këndojnë me zë të lartë trimëritë e tij nëpër gostitë, siç thamë, dhe e quajnë Skënderbeun tonë, për antonomasi, me emrin e shquar *Kulçedra e Arbënit* dmth. dragoi i Epirit.» (Shih nr. 80)

7 (1637)

Bardhi, Frang, Relacion dërguar Vatikanit mbi vizitën e Pukës — qershor 1637. (I. Zamputi. Mbi disa materiale të reja dokumentare të shek. XVII Buletin i Universitetit Sht. të Tiranës, Sh.Sh. 1958, nr. 3, f. 204 dhe Burime të Zgjedhura për Historinë e Shqipërisë. Vëll. III 1506-1839 f. 202). / (Në Pukë) ...sipas zakonit të të moçëmve, ndër gostitë e tyre, nëpër rrugë e në punë, këndojnë me zë të lartë trimëritë e burrave të tyre të mëdhenj, dhe sidomos të të pathyeshmit zot, zotit Gjergj Kastriotit, të quajturit Skënderbe, dhe të të shkëlqyeshmit zotit Lekë Dukagjinit, princit dhe zotit të yre...» (Shih nr. 88, 93).

8 (1671)

Çelebi, Evlia, Shqipnija para dy shekujsh (Përkthe nga Salih Vuçiterni). Tiranë 1930³ / f. 126 shënon se një lagje në qytetin e Ohrit mban emrin e Skënderbeut.

9 (1742)

Biemmi, Giammaria, Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh. Brescia 1742 / F. 227-228 flet për ëndrrat e çuditshme që shihnin njerëzit nga paniku turk (afër Petrelës ishin parë dy ushtri fantastike me armë të ndriçme prej ari; pranë Krujës disa net me radhë, ishin dukur me mijra lubira, që nxirrnin flakë nga sytë dhe nga goja, dhe që i vinin rrotull fortesës, duke dashur ta përpjninë; në Branteshkozë, në mes të ditës, ishin parë tri hëna, që ndritnin aq sa edhe dielli; në Muzakianë kish rënë shi me gurë; Drini në Rubrë dhe Ishmi në Gjatë ishin skuqur e rridhnin gjak të mpiksuar etj.); f. 228-229 ëndrra e Sk. për të qetësuar popullin; f. 482 kërkesa e sulltanit për të huajtur shpatën e magjepsur të Sk.

10 (1805)

Pouqueville, F.C.H.L., Voyage en Morée, à Constantinople, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l'Empire Ottoman pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801. Paris 1805. / Në vëllimin III kap. XXVII f. 288: «Këta djem të maleve të Çikës këngët e tyre, që shtyhen në shekujt e Skënderbeut të lavdishëm, shefit të tyre... i përdorin për të sharë dobësinë e osmanëve».

Vëll. III, kap. III f. 19: «Si më kanë thënë ata që i dinin, këngët ishin të vjetra qysh në kohët e Sk.»

11 (1808)

Hatry, M. (Monsieur?) Journal de voyage fait en Albanie et à Corfou par ordre de S.A.I. Monseigneur le Prince Viceroi d'Italie, par M. Hatry, capitaine aide de

3) Shënimet në origjinal janë të vitit 1671.

camp. 1er Février 1808. / Në këtë dokument që gjendet në dorëshkrim në Arkivat e Ministrisë së ushtrive (tokësore), shërbimi historik i Ushtrisë, Shatorre e Mbretit, Kështjella Vensënë (Archives du Ministère des Armées (Terre), Service historique de l'Armée, Pavillon du Roi, Château de Vincennes), thuhet midis të tjerash: «Në Lezhë... shqiptarët e krishterë nuk flasin kurrë për Skënderbenë, pa veneracion; ata këndojnë akoma edhe sot për nder të tij një këngë (romancë) të vjetër që nuk është pa bukuri, përkthimin e së cilës po e jap në fund të këtyre shënimeve.»

Ky dokument është gjetur nga studjuesja franceze Odile Daniel.

12 (1831)

Didier, Charles, Souvenirs de Calabre — Les Albanais en Italie. Revue de deux mondes. Paris 1831. / Midis këngëve popullore arbëreshe, që jepen këtu të përkthyer në frëngjisht, është edhe kënga e Kostantinit të vogël, heronë e së cilës arbëreshët e kujtonin vëllanë e Sk.

13 (1840)

Boué, Ami, La Turquie d'Europe. Paris 1840 / Në vëll. II f. 108 thuhet: «në veri, Hot, Shalë këngët popullore kanë si hero Gjergj Kastriotin, kurse në jug këndohet akoma për luftat e Arianit Golem Topisë, që ish lidhur me Skënderbenë për të përzënë turqit nga Epiri.»

14 (1845)

Staffa, Felice, Canti albanesi parafrasati. Napoli 1845 / Jep të përkthyer në italisht subjektin e këngës «Motra e Sk.» pa përmendur emrin e heroit.

15 (1847)

Dorsa, Vincenzo, Sugli Albanesi. Ricerche e pensieri. Napoli 1847. / Në f. 126 jep të përkthyer në italisht këngën «Skënderbeu dhe vdekja» (Canto eroico relativo a Scanderbek).

U riprodhua italisht (kjo këngë) nga Camarda-Appendice f. XVI n.a; u përkthye frëngjisht nga Dora d'Istria — La nat. alb. 404, inglisht nga Toser RHT II 217, shqip nga Mitko Blea shqyp. f. 98.

Dh. S. Shuteriqi. Buletin ISH 1949, nr. 2 f. 11 shën. 40.

16 (1866)

Camarda, Demetrio, Appendice al Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese. Prato 1866 / Në XVI n.a riprodhon në italisht këngën arbëreshe «Sk. dhe vdekja».

17 (1866)

De Rada, Girolamo, Rapsodie d'un poema albanese. Firenze 1866. / Boton në të folmen arbëreshe dhe të përkthyer në italisht tetë këngët e njohura për Skënderbenë: 1) Trimi dhe vasha (f. 33) 2) Motra e Skënderbeut (f. 64) 3) Sk. dhe Miloshini (f. 66) 4) Martesa e Sk. (f. 72) 5) Sk. e Ballabani (f. 76) 6) Vjehrra e keqe (f. 81) 7) Sk. e vdekja (f. 84) 8) Vdekja e Sk. (f. 89).

Është botimi i parë i plotë i këtij cikli që ka shërbyer si bazë edhe për botimet e tjera të këtyre këngëve.

Në këtë vëllim janë dhënë edhe këngë për heronj të tjerë — Dede Skurën, Pal Golemin, Nik Petën, Radha Vanin, Pjetër Shinin, që sjellin atmosferën e luftrave kundër turqve të shek. XV e XVI. (Shih nr. 24, 36, 98)

18 (1866)

D'Istria, Dora, La nationalité albanaise d'après les chants populaires. Revue des deux mondes. Paris 1866 / f. 404 jep të përkthyer në frëngjisht këngën arbëreshe «Sk. dhe vdekja».

19 (1867)

Hahn, Johan George von, Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar. Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Fünfzehnter Band. Wien 1867 / f. 19-25 flet për ekzistencën në Mat të toponimeve dhe të kanunit të Sk., për ekzistencën e gojëdhënave rreth heroit dhe për motivet interesante të tyre, të cilat i krahason me sagat gjermanike, sidomos me ato të mbretit të Gotëve, Teodorikut, duke u përpjekur të gjejë ndër ta, sipas teorie krahasimtare, që ishin në vogë në atë kohë, një burim të përbashkët indoevropian.

Autori ka bërë përpjekje edhe për gjurmimin e këngëve popullore rreth Sk. Pleqtë me të cilët është takuar, i kanë thënë se këto këngë kanë qenë kënduar më parë, por tani nuk mbaheshin mend më.

20 (1869)

Hahn, Johan George von, Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar. Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Sechzehnter Band. Wien 1869 / Përmenden toponime që lidhen me emrin e Sk.: f. 8: Qafa Skanderbegut dhe Mali (vargmali) Skanderbeg (midis Krujës e Matit); f. 10 e 11: Varoshi, Qyteti Skanderbegut; f. 14 Mali Skanderbeg (Mat).

21 (1869)

Tozer, H.F. Researches in the Hinglands of Turkey. London 1869. / II 217 jepet e përkthyer në inglisht kënga arbëreshe «Sk. dhe vdekja».

22 (1876)

Rugiero, Goffredo, Saggi di canti albanesi volti in vresi italiani. Cosenza 1876. / Bonton në italisht këngët: Sk. dhe Ballabani f. 28, Vjehrra e keqe f. 33, Sk. dhe Miloshini, f. 49, Trimi dhe vasha f. 53, Motra e Sk. f. 53, Sk. dhe vdekja f. 70, Vdekja e Sk. f. 73.

23 (1878)

Mitko, Eftim, Alvaniqi Melissa (Bëleta Shqypëtare) Aleksandri 1878. / Në f. 98 jep shqip këngën arbëreshe «Sk. dhe vdekja».

24 (1886)

Tajani, Francesco, Le storie albanesi. Salerno 1886 / mbi çfaqjet popullore rreth luftrave të Sk., që kanë pasë zakon të japin arbëreshët e Italisë në raste përvjetoresh të fitoreve mbi turqit.

25 (1883-1887)

De Rada, Girolamo, Rapsodie nazionali. Cosenza 1883-1887 / Ribotohen tekstualisht të tetë këngët e Sk. dhënë më 1866 në Rapsodie d'un poema albanese. (Shih nr. 17)

26 (1889)

De Grazia, Demetrio, Canti popolari albanesi tradizionali nel Mezzogiorno d'Italia — Riordinati, tradotti e illustrati Noto 1889 — Boton të stilizuara në vargje italisht, krahas përkthimit italisht të De Radës, të tetë këngët arbëreshe të Sk. (marrë nga De Rada).

27 (1891)

Smilari, A. Gli Albanesi in Italia. Napoli 1891 / Boton në prozë italisht këngët «Sk. dhe Ballabanii», «Sk. dhe vdekja», «Sk. dhe Miloshini» (këtë të fundit në dy variante) (f. 31, 52, 53, 58)

28 (1894)

Draganov, P., Makedonsko-sllavjankij sbornik. S. Peterburg 1894 Lib. XXXIV, 238 / Jepen 7 këngë sllave për Sk. të treguara nga një nxënës i shkollës së mesme sllave në Selanik me origjinë prej Galishnikut të Maqedonisë. Tematika dhe ndërtimi i këtyre këngëve të kujton poezitë me frymë popullore të shkruara për heroin tonë nga A. Mioshiq-Kaçiqi.

29 (1896)

Stratico, A. Manuale di letteratura albanese. Milano 1896. / f. 127 gojëdhëna e tërheqjes rrëshanas te Sk., kur ish fëmi, për të prekur armët e t'et dhe goj. për cilësitë e jashtëzakonshme të heroit.

30 (1898)

Nazione albanese 1898-16/8 [Jepen në italisht 4 elemente nga tradita e Sk. 1) Forca e Sk. 2) Sk. e Ferdinandi 3) Sk. ke Papa Pavli I 4) Rruga e Sk. në Romë.

31 (1901)

Ippen, Th. La topographie des campagnes de Scanderbeg contre les Turcs. Albania V (1901). / Me interes për lokalizimin e disa legjendave të Sk. lidhur me toponimet e Barletit dhe të Biemit.

Nr. 7 f. 106-108 1. Alboula ose Albulae 2. Alkharia 3. Chidna 4. Mekhadio 5. Modrisa.

Nr. 9 f. 139-141 6. Mokri 7. Oroniki ose Oronitche 8. Otoneta 9. Petralba 10. Rovico (pranë Svetigradit) 11. Stelusium 12. Svetigrad 13. Talmirana 14. Torviolo 15. Tuminist 16. Valkahl.

32 (1901)

Degradand, A. Souvenirs de la Haute Albanie, Paris 1901 / Midis kujtimeve që ka pasur nga Kruja boton në f. 225 edhe këngën «Complainte albanaise chantée

à Croia» (vaj shqiptar që këndohet në Krujë), ku bëhet fjalë për luftimet midis forcave shqiptare të kryesuara nga Tanush Topia dhe ushtrive turke që kryesoheshin nga Ballaban Pasha. Është përkthyer dhe botuar si këngë popullore në rev. Leka 1933 f. 118 dhe në Visaret e Kombit I f. 3-4 (Shih nr. 54, 57)

33 (1901)

K., L., Kujtime kombëtare. *Kalendari kombiar*. Sofie. Shtypshkronja Mbrothësia 1901 f. 56. / Botohen tri gojdhëna që tregohen për Sk. në fshatrat Bixulle, Preçë e Mollagjesh të Elbasanit.

Bixullenë e uroi Sk. për mbarësi, Mollagjeshit t'i rriten pyjet e kullotat; Preçën e nëmi: «Qofshi nantë shtëpi e mos u bafshi dhetë kurrë!»

34 (1905-1906)

Lkeni i Hasit (Shtjefën Gjeçovi) Gjergj Kastrioti Skendërbegu (Gojdhënat e popullit t'Kurbinit e t'Kruës). Albania. London IX 1905, nr. 12 f. 226-227; X 1906, nr. 1 f. 6, nr. 2 f. 27-28, nr. 4 f. 62-64. / Botohen 16 tregime popullore të mbledhura në Kurbin e në Krujë:

1905 f. 226-227: 1) Mullini-Fall n'Hurdhaz (Kurbii); 2) Mali Skendërbeg n'katun t'Vinjallit n'Kurbi (përmi Shkretë); 3) Kroj-Skenderbeg n'Qafgëlqere (n'Lyne t'Skurait); 4) Kroj-Skendërbeg n'Grykë t'Altarit (Milot); 5) Gurr-Mamica (n'rraz t'malit t'Bazes); 6) Buza e Skendërbegut edhe Kroj-Skendërbeg (n'mal t'Trodhnes përmi Vinjall t'Kurbinit); në vitin 1906: në nr. 1: 7) Poçi i venës n'shpi t'Malçaive n'katun t'Skurait n'Kurbi; 8) Diëja e Kok Malçit e gjoba e marrun për openga; në nr. 2: 9) Nji pleqni e dame prej Skendërbegut e Kok Malçit e gjoba e marrun për openga; 10) Vrasa e Ballaban Pashës mas popullit; nr. 4: 11) Gojdhëna e gjytetasve t'Kruës; 12) Gjelat e Tiranës t'namun prej Skendërbegut; 13) Kuvëni i Gjergj Kastriotit e Lekë Dukagjinit; 14) Skendërbegu me treqin ushtarë n'Nershezë (Mali i Mirditës); 15) Skendërbegu n'katun t'Shebës, n'Thkellë t'Epër, n'shpi t'Gjikajve; 16) Kalaja e Skendërbegut.

Është e para mbledhje e rëndësishme e gojdhënave të Sk. (Shih nr. 89)

35 (1911)

Prenushi, Vincenc, Kangë popullore gënishte. Saraevo, 1911. / f. 13 në këngën e Gjini Lekës: *Por thuej Pashs edhe Allaj Begut, / s'lidhen t'biqt e Skenderbegut*; f. 53 në k. «Bajraktar, sokol me fletë»: *Bajnë henek t'luftojne mas bregut / me të nipat e Skanderbegut; / Skanderbegu rrafe prej qiullet, / pashallarvet ja u njeft hilet*; f. 98 në k. «Njaj Gjokë Gjeta shilon atin» gërshetohen vargje, që paraqesin ngjarje të kohës së Sk. «*Skanderbegu i kruetanë, / aj veç shtron të tanë dynjanë... Sk. kishte thanë: / me gjashtdhetë pushkë qi kam marrë, / me gjashtdhetë djelm qi kam marrë, / do ta shtroj te tanë dynjanë... Ali Pashë a di ç't'baq une? / Se bash me dorë kam me t'xanë!... Sk. si ju fut mrena / te tanë botës i lufti menja... Ne Vidin un ty te la, / qi mos t'baqsh or shka ke ba... Sk. ti m'kjoftsh bekue!* (Shih nr. 89)

36 (1912)

Scura, Antonio, Gli Albanesi in Italia e i loro canti tradizionali. New York 1912. / Botohen në të folmen arbëreshe dhe të përkthyer italisht këngët: 1) Trimi

dhe vasha (f. 182); 2) Motra e Sk. (f. 238); 3) Sk. e Miloshini (f. 246); 4) Mar-tesa e Sk. (f. 250); 5) Sk. e Ballabani (f. 254); 6) Sk. e vdekja (f. 264); 7) Vdekja e Sk. (f. 289) Që të gjitha të njëjta me ato të De Radës (shih nr. 17). Mungon prej koleksionit të tij vetëm kënga e «Vjehrrës së keqe». (Shih nr. 90)

37 (1916)

Bilotta, Bernardo, Canti albanesi (ridda). Castrovillari 1916 / f. 1-3 jepet në të folmen arbëreshe «Kënka Skanderbekut» (55 vargje). Është një përzierje e motiveve të këngëve «Sk. dhe Miloshini», «Sk. dhe Ballabani» dhe «Pjetër Shini».

38 (1917)

Larmbertz, Maximilian, Die Volkspoesie der Albaner. Eine einfuhrende Studie. Sarajevo 1917.

39 (1918-1919)

Rvista «Kopështi letrar» Elbasan 1918-1919 / Boton gojëdhënat: Sk. në liqen t'Ohrit, Sk. në Rraicë, Sk. në Griqan, Sk. në Bixëlle (1918, nr. 1 f. 15-16); Sk. në Gurtë të bardhë (nr. 2 f. 9); Sopotit (nr. 4 f. 14-15), Lufta e Mëlizës (1919 nr. 6 f. 14).

40 (1919)

Jorga, N. Brève histoire de l'Albanie et du peuple albanais. Bucarest 1919. / f. 45. Midis së tjerash ka tërhequr vëmendjen se një nga burimet që ka shfrytëzuar Barleti për hartimin e veprës së tij ka qenë edhe tradita popullore.

41 (1920)

Sirdani, Marin, Skanderbegu mbas gojëdhënash. Zâni i Shna Ndout. 1920, nr. 1 f. 25-28; nr. 3 f. 76-80, nr. 4 f. 104-108, nr. 5 f. 136, nr. 6 f. 159-160. / Botohen një numër legjendash që përmbliken më vonë (1926) në vëllimin «Sk. mbas gojëdhanash» (Shih nr. 47)

42 (1921)

Noli, Fan S. Historia e Skënderbeut. Boston 1921 / f. 89 legjendat për lindjen e Sk. (E ëma pa në ëndërr se lindi një dragua; Gjergji, kur lindi, kish në krahun e djathtë një shpatë të shkruar); f. 132-133 këngët e vjershat, elegjirat e improvizuara pas betejës së Torviollit. f. 168-170 ëndrra e Sk. dhe supersticionet popullore; f. 180 kremtimi i çlirimit të Krujës më darkëra, valle, tostongale dhe turrea; f. 222 beteja e Albulenës u këndua me vjersha an'e mb'anë Shqipërisë; f. 249 shkëmbimi i dhuratave me Ballabanin (dërgimi i një kërrabe dhe një pluari nga Sk. për t'i treguar se do të kish patur më tepër nder, sikur të kish mbetur bari dhe bujk në Mat); f. 267-268 vajtimi i Sk. sipas mënyrës shqiptare; f. 270-271 këngët që këndoheshin për Sk. pas vdekjes së tij.

43 (1924)

Suflay, Milan, Povijest sjevernih Arbanasa. Arhiv za Arbanaski starinu. Kniga II

1924. / Sk. si më i madhi dhe më i rrebtë luftëtar që krijoi në përgjithësi lufta e Evropës me Turqit. Mbulimi me legjendë i heroit tonë nga Evropa që në kohën e rrotjes së tij. Idealizimi i figurës së Sk. nga popujt ballkanikë.

44 (1924)

Bellusci, F. Epica albanese. Corigliano Calabro 1924.

45 (1925?)

Erdelanovic, Jovan, Makedonske pesme o Skenderbegu (?)

46 (1926)

Suflay, Milan, Serbët dhe shqiptarët. / f. 195, 196: Ky (Sk.) edhe për së gjalli u madhnue prej Evropës perëndimore me legjenda të ndryshme burrnije. Fantazija e popujve të Ballkaniit krijou prej tij kreshnikun e vjerrshavet e të prallave të bukra qi ka.
(Botim i origjinalit 1925)

47 (1926)

Sirdani, Marin, Skanderbegu mbas gojëdhanash. Shkodër 1926.

Është e vetmja përmbledhje e gjerë e traditës gojore, që u bë para çlirimit për Sk. Në të jepen të renditura sipas një farë kriteri kronologjik gojëdhëna të mbledhura në krahinën e Kurbinit (Krujë) dhe në atë të Rranxës (Mat), këngë popullore epike arbëreshe të kohës së Skënderbeut, të këthyera në prozë, si edhe një numër këngësh të epikës historike të periudhës së Sk. ose më të hershme.

Vëllimi ndahet në dy pjesë: a) Kallxime tradicionare dhe b) Kangë tradicionare.

Në pjesën e parë përfshihen:

I. *Luftat e Skanderbegut* 1) Lindja e Sk. 2) E motra e Sk. 3) Ardhja e Sk. në vendleje 4) Përpjekja e Sk. me Kokë Malçin e lufta me Ballabanin 5) Lufta e Sk. me Ballabanin 6) Fejesa e Sk. 7) Sk. e Milo Shini 8) Milo Shini e Ali Begu 9) Vrasa e Sulltan Muratit 10) Sk. në dhe të Lëtinit 11) Pjetër Shini 12) Lekë Dukagjini e Duka i Dejës 13) Kushti i Sk. 14) Lekët e Sk. f. 21-58.

II. *Udhëtimet e gjyqjet e Skanderbegut* 1) Beja e Lekë Dukagjinit 2) Sk. në Mat 3) Sk. udhëton nëpër Rranxë 4) Të ritë e Mamicës 5) Dredhija e Mamicës 6) Veletija e Kokë Malçit 7) Sqetija e Kokë Malçit 8) Murgjani i Sk. f. 59-76.

III. *Vdeka e Skanderbegut* 1) Andërra e Sk. 2) Lufta e mbrame e Sk. 3) Vdeka e Sk. f. 77-86.

IV. *Mergimi i Shqyptarëve* 1) Grabitja e të shoqes së Nik Petës 2) Radovani e e motra, Rina 3) Vdeka e Pal Golemit e e Dedi Skurës 4) Selim Pasha e mizorit e Turkut 5) Shkodra, Drishti e Krueja pushtohen prej Turkut 6) Luftat e Gjon Kastriotit 7) Ushëterija turke përshkon Dukagjinin 8) Gjendja e Krishtenimit në të XV shekull 9) Shqyptarët kristjan e muhamedan kundra Turkut f. 86-140.

Nga kapitujt e sipërm nr. 1,3,4,9,14 të kapit. I dhe 1-8 të kap. II janë

elemente origjinale të traditës popullore. Ndonjë fragment legjende si ato që jepen në f. 21, 22, është marrë nga Barleti (shih nr. 1), ndonjë tjetër nga Stratikoi (shih nr. 29), të tjerat janë këngë arbëreshe të përshtatura në prozë, ose ngjarje historike të kallxuara në frymën popullore.

Në pjesën e dytë janë dhënë tekste këngësh popullore shqiptare dhe arbëreshe të ndara në 3 kapituj:

I. *Skanderbegu* 1) Sk. e Ali Pasha 2) Sk. e Ballabani 3) Motra e Sk. 4) Milo Shini e Sk. 5) Fejesa e Sk. 6) Kushti i Sk. 7) Besa e burrit 8) Sk. e mordja 9) Vdekja e Sk. f. 141-160.

II. *Kreshnikët* 1) Milo Shini e Ali Begu 2) Lekë Dukagjini 3) Pjetër Shini 4) Dedë Skura 5) Pal Golemi 6) I biri i Pjetër Shinit 7) Radovani 8) Vdekja e Radovani 9) Grabija 10) Vlastari 11) Kostantini e Garentina 12) Halil Garrija 13) Kostantini i vogël 14) Aga Ymeri 15) Kotuzi 16) Gjergj Elez Alija 17) Rozafati 18) Hyseni i vogël 19) Gjeto Basho Muja 20) Ali Begu 21) Arnaut Osmani 22) Muji e Behuri f. 160-226.

III. *Mjerime e mërgime* 1) Vaji i Mores 2) Garadini 3) Lajmi i zi 4) Dy zoglat 5) Nema 6) Burgu 7) Olimpia e Vlastari 8) Hasri Asali 9) Gjon Pretika 10) Vorri i trimit 11) Ushtari tuj vdekë 12) Dallnysha 13) Kushti 14) Murgjani 15) Murgesha 16) Dyndja 7) Lamtumirë e vendit f. 227-246.

Në kapit. I të kësaj pjese të dytë janë paraqitur 8 këngë që i përkasin Skënderbeut: e para nga folklori shqiptar — ribotim i një kënge të vëll. Vi-sari komtar (shih nr. 35) dhe 7 këngë arbëreshe; kënga nr. 7 është një këngë legjendare e folklorit arbëresh.

Në kapit. II e III jepen këngë të ndryshme të epikës historike shqiptare dhe arbëreshe, që i përkasin një shtrese të hershme të krijimtarisë poetike popullore, në një farë mënyre edhe periudhës së Sk.

Këngët arbëreshe janë dhënë në dialektin e tyre origjinal dhe të kthyer në gjuhën e sotme.

Në f. 246 të vëllimit shënohen përmbledhtas si «shtojcë» disa emra kë-shtjellash, krojesh, gurrash e vendesh të tjera që njihen në popull me emrin e Sk.

Reç. N. Jokl. Alb. 1926 nr. 134.

48 (1928)

Jovanovic, Toma i Vujic, Dorote Kastriotiç Skenderbeg. Beograd 1928, f. 77 / 16 këngë popullore (?)

49 (1929)

R. H., Skënderbeu në Bulqizë.

Skënderbeu në liqe të zi. Normalisti, Elbasan 1929.

50 (1930)

Gojdhanat mbi Gurin e Skënderbeut që gjëndet në kat. Burrarë (Tiranë). Edukata e Re. 1930, nr. 4 f. 159.

51 (1931)

(*Blakçori, Jonuz.*) Sadriazemi një pashë i ri, *Edukata e re* 1931, f. 302. / Këngë në frymë popullore për Sk. (13v.). Sipas shënimeve të botuesit këndohet në «disa vise të Kosovës».

52 (1931)

Sirdani, Marin, Zëmbra e Skanderbegut (Histori e legenda). *Hylli i Dritës*. Shkodër 1931 nr. 5 f. 291-299. / 1. Shperblimi i robve, 2. Mshira për të mjeruem, 3. Kapidani i nemun, 4. Robi turk, 5. Ushtari i egër, 6. Motra velete, 7. Tradhëtori i falun, 8. Nji pleqni, 9. Nderimi ma i madhi, 10. Stima e meritue. Nr. 1, 2, 4, 5, 7, 9, 10 tregime me frymë popullore të nxjerra nga letërsia historike (Anonimi e Biemi); nr. 3, 6, 8 gojëdhëna të ribotuar nga vëllimi «Sk. mbas gojëdhanash» (shih nr. 47).

53 (1932)

Sirdani, Marin, Një rival i Skanderbegut. *Hylli i Dritës* 1932 nr. 7-8, f. 385-395; nr. 9 f. 437-443; nr. 12 f. 617-625 / Midis të dhënave historike për Lekë Dukagjinin janë shënuar edhe elemente të traditës popullore si ajo për ndarjen e kufijve ndërmjet Sk. e Lekës (beja e parotës me tokën e truallit të Lekës nën çorape), e mbathjes së kafshëve me patkoj prapë, vajtimi i L.D. në vdekjen e Sk. etj.

54 (1933)

Harapi, Z.M. Deka e Ballaban Pashës. *Leka*. Shkodër 1933, f. 118 / Përkthim i këngës së A. Degrand-it (shih nr. 32)

55 (1933)

Taipi, Kasem, Zana popullore. Shkodër 1933. / f. 201 në k. e Gjin Lekës: *Por thuej Pashës e Allaj Begut, / s'lidhen të birët e Skanderbegut; f. 228: Me luftue si e pat zakonë / Skenderbegu baba i jonë.*

56 (1936)

Gjelaj, F., Guri i Skanderbegut dhe mullini me erë (gojëdhanë) (Fandë). *Cirka* 1936, nr. 4 f. 60-61.

57 (1937)

Skandërbegu nuk ka dekë (këngë popullore. Krue). *Visaret e Kombit I* 1937 f. 3-4. / Ribotim (shih nr. 32 e 54).

58 (1938)

Kormaku, Vahid, Golloborda, shesh i betejave të Skënderbeut. Orveniku-Modriçi-Meçoku. *Drita*. Tiranë 25.9.1938. z

59 (1938)

Pall, Francesco, Marino Barlezio — uno storico umanista. București 1938. / Në f. 34 dhe 43 flitet për burimet gojore që ka shfrytëzuar Barleti në hartimin e veprave të tij; në f. 46-49 trajtohet në mënyrë të veçantë çështja e shfrytëzimit të traditës popullore. Pali shtron mundësinë e mbledhjes së këtyre të dhënave gojore nëpër udhëtimet që duhet të ketë bërë Barleti para pushtimit të Shko-

drës prej turqvet d.m.th. para vitit 1479. Megjithëkëtë nuk përjashtohet edhe mundësia e udhëtimeve të tij nëpër krahina të ndryshme të vendit edhe pas kësaj date.

Me interes janë edhe krahasimet që bëhen midis disa këngëve popullore arbëreshe për Sk. dhe të dhënave të Barletit (Vajtimi i Lekë Dukagjinit etj.) (f. 127-129).

60 (1938)

Zhari, *Shahin*, Kanga e Gjorq Golemit, Princit të Sopotit. Shkolla kombtare 1938, nr. 15-16, f. 22. / Jepet, e shoqëruar edhe me shënime, kënga e sipërme; është mbledhur në fshatin Bërzeshtë të Elbasanit.

61 (1940)

Gj., *M.*, Bushkashi. Shkolla shqiptare 1940.

62 (1940)

Folklorë III. Shkodër 1940. / f. 14 në këngën «Kur çojnë me marrë nusen»: *Ajo vashë si e bija e begut / paska florijt e Skanderbegut*. f. 21 «Nina nina, o more bir»: *Flej, o djalë, se të ka falë zoti, / u bash trim si Kastrioti*. f. 33 «Hajde, o gjumë, ti ç'ka kërkove»: *Ti m'u rritsh m'u bash si beg, / dalsh si i dyti Skanderbeg*, f. 38 «Nina nina, flej moj zemer»: *Sundosh tokët*.

63 (1941)

Liperi, *Dhosi*, Gojëdhana popullore mbi Skënderbeun (mbl. në Mat) *Tomorri*, Tiranë 1.IV.1941.

64 (1941)

Petrota, *Rosolino*, Arbëresht në Siqeli. Tiranë 1941 / f. 36... «populli shqiptar edhe sot e kujton në kënkat e tij popullore të mrekullueshme ...historinë epike të Sk.»

65 (1943)

Bota shqiptare. Tiranë 1943 / f. 67 Gojëdhëna e themelimit të fisit të Dukagjinëve; f. 87 Sopot; f. 89 Lufta e Mëlizës; f. 208 Lindja e Sk. f. 217 familja e Dukagjinet; f. 219 Sk. e Milo Shini (vargje); f. 222 Lufta e Sk. me Ballabanin (prozë); f. 225 Sk. me treqind ushtarë në Nershez; f. 226 Poçi i venës në shtëpi të Malçajvet në katund të Skurait n'Kurbi; f. 227 Kushqimi i Sk. (Martesa e Sk.) (vargje); f. 232 Deka e Ballaban Pashës; f. 239 Sk. e vdekja; f. 242 Vdekja e Sk. f. 247 Vjett e mbrame të Lekë Dukagjinit (gojëdhanë).
Pothuajse të gjitha ribotime.

66 (1943)

Sevari Gojëdhanë mbi Kongresin e Leshit (1444). *Drini* 1943, nr. 6-7, f. 20.

67 (1944)

Visaret e Kombit. Vëll. XIII. Tiranë 1944 / 154 gojëdhanë për luftën e Mëlizës dhe

Petro Kapedanin; f. 173, 174 Gojëdhëna e themelimit të Shushicës (Elbasan) e gërshetuar me atë të pushtimit të Sopotit nga Sulltan Mehmeti II, Fatiu. <

68 (1949)

Sako, Zihni, Skënderbeu në legjendën popullore dhe në letërsinë artistike ndërkombëtare. *Zëri i Popullit*. 1949, 16 janar.

69 (1949)

Shuteriqi, Dhimitër S., Legjenda e Skënderbeut. Buletin i Institutit të Shkencave. 1949, nr. 2 f. 3-51. / Studim i gjerë dhe me interes, sidomos për shqyrtimin e gjenezës së këngëve popullore arbëreshe rreth Sk. Monografia përmbledh këto kapituj: Hyrje f. 3-8; I Sk. në poezinë epike t'arbëreshëve t'Italisë f. 8-9; II. Mbledhja e këngëve mi Sk. nër kolonitë arbëreshe t'Italisë f. 10-14; III. Studimi i këngëve f. 15-30; IV. Vështrim i përgjithshëm f. 30-38; V. Përfundim f. 38-47; Bibliografi f. 48-51.

A., pasi trajton problemet e sipërme, duke i parë edhe në një kuadër krahasues (lidhur me pikat e përbashkëta, që paraqesin këngët e Sk. me këngët akritike etj.) arrin në përfundimin se këto këngë (këngët e Sk.) nuk duhet të jenë me origjinë autentike popullore, por ka mundësi të jenë krijuar nga poetë me shkollë në pjesën e parë të shek. XIX, afërisht brenda viteve 1839-61. Krijuesit e tyre duhet të jenë sidomos Santori dhe De Rada, ndofta dhe Dorsa.

Ato janë krijuar në frymën dhe mbi shtratin popullor, duke gërshetuar emrin e Sk. në këngë popullore ekzistuese (Trimi e vasha, Vjehrra e keqe); duke i zënë vendin Sk. një personazhi tjetër (Motra e Sk., Sk. dhe Miloshini), duke u mbështetur në ngjarje të burimit historik (Martesa e Sk., Sk. dhe Ballabani, Sk. dhe Vdekja; Vdekja e Sk.).

Këngët arbëreshe për Sk. të përhapura me anë të dorëshkrimit të Santorit dhe të botimit të De Radës duhet të kenë qenë kënduar nëpër fshatra arbëreshe të Kalabrisë, duke u mbledhur më vonë si krijime popullore nga folkloristë të ndryshëm.

70 (1949)

Shuteriqi, Dhimitër S., Këngë popullore mbi Skënderbenë. *Literatura jonë*. III 1949 nr. 5 f. 17-21 / Jepen me shënime 2 këngë për Sk. «Rrethimi i Krujës (1450)» e «Sadriazemi një pashë i ri» si edhe kënga e Gjorg Golemit.

Me interes shënimet rreth regjistrimit të këngës së parë.

71 (1952)

Ceka, Hasan, Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftave të Skënderbeut sipas Barletit. Buletin për Shkencat Shoqërore 1952, nr. 3 f. 21-35. / Paraqit interes për lokalizimin e disa gojëdhënave të Sk. lidhur me toponimet që përmenden nga Barleti.

72 (1952)

Kodra, Ziaudin, Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe Tekst për, kl. e III të Shkollave të mesme. Tiranë 1952 / Epet në të folmen arbëreshe dhe në gjuhën e

sotme kënga Skënderbeu e Ballabani f. 74-75. Po kështu në f. 75-82 edhe këngë të tjera arbëreshe rreth ngjarjeve të kësaj periudhe si Nik Peta, Pal Golemi, Dedi Skura, Pjetër Shini etj.

73 (1954)

Trajtimi i disa toponimeve, legjendave e këngëve të reja rreth Skënderbeut e shokëve të tij. *Buletin për Shkencat Shoqërore* 1954, nr. 3 f. 103-115. / 1. Rreth toponimit «Tevioll»; 2. Legjenda rreth Lek Zaharisë, vrasjes së tij dhe vendit ku u krye vrasja; 3. Legjenda rreth Lek Dushmanit; 4. Legjenda rreth Orvenikut; 5. Legjenda rreth Ballshit; 6. Legjenda rreth Albulenës; 7. Këngët popullore rreth Sk.; 8. Legjenda rreth Sk.

74 (1955)

Kodra, Ziaudin, Skënderbeu në rapsoditë arbëreshe. *Nëndori* 1955, nr. 1 f. 154-163.

75 (1955)

Shuteriqi, Dhimitër S., Kënga e popullit. Tiranë 1955. / f. 223 kënga Ky Murani i parë në Krue; f. 224 Martesa e Sk; f. 226 Vdekja e Skënderbeut; f. 227 Gjorg Golemi. Në f. 322, 323 shënime për këngët e sipërme.

76 (1955)

Varfi, Andrea, Skënderbeu në zëmrat dhe këngët e popullit tonë. *Zëri i Popullit* 1955, (16 janar).

77 (1955)

Sako, Zihni, Folklori shqiptar. Tekst për kl. e I e II të shkollave të mesme. Botim i dytë. Tiranë 1955 / f. 89-90 jepen me shënime këngët «Sk. flet një fjalë» dhe «Rrethimi i Krujës»; f. 91 gojëdhënat «Armët e Sk.» dhe «Një kshillë e Sk.»; f. 92 kënga e Gjorg Golemit.

78 (1956)

Instituti i Shkencave, Këngë popullore historike. Zgjedhur e pajisur me shënime nga *Qemal Haxhihasani* nën kujdesin e *Zihni Sakos*. Tiranë 1956. / Botohen 61 tregime popullore për Sk. f. 45-57; 3 këngë popullore (Sk. kishte thanë f. 43, Ky Murani i parë në Krue f. 44, Sadriazemi nji pashë i ri f. 45); 6 këngë popullore arbëreshe (E motra e Sk. f. 58, Sk. dhe Miloshini f. 60, Martesa e Sk. f. 64, Sk. dhe Ballabani f. 66, Sk. dhe vdekja f. 72, Vdekja e Sk. f. 74); 2 këngë maqedonisht (se ozhena mascek Skënderbeg f. 76, Po sakall Skënderbeg f. 78); kënga Dekë e Ballaban Pashës f. 78; kënga e Gjorg Golemit f. 81 dhe 10 këngë arbëreshe f. 84-103, që sjellin jehonën e periudhës së Sk.

Shumica e tregimeve janë të mbledhura pas çlirimit, këngët janë ribotim. Tekstet arbëreshe jepen në të folmen e tyre origjinale dhe të këthyera në gjuhën e sotme. Në hyrje trajtohet në vija të përgjithshme problemi i ruajtjes së tregimeve popullore dhe ai i zhdukjes së këngëve rreth heroit f. 6-11.

79 (1957)

Kodra, Ziaudin, Poezija popullore arbëreshe. Tiranë 1957. / Botohen në të folmen arbëreshe dhe të këthyera në gjuhën e sotme 7 këngët e Sk. (në këngën e tetë Vjehrra e ligë f. 125 nuk përmendet emri i heroit) (f. 7, 11, 17, 21, 29, 35, 37). Këngët janë marrë nga vëll. i Skurës.

80 (1957)

Bardhi, Frang, Skënderbeu (Apollogji) përktheu nga latinishtja prof. S.I. Prifti. Tiranë 1957 / f. 73 citati për këngët e Sk. (shih nr. 6).

81 (1957)

Giordano, Emanuele, Folklore albanese in Italia. Cosenza 1957 / f. 7 përshkruhen disa zakone interesante të kolonive arbëreshe të Frashinetës e të Ejaninës, ku ruhet jehona e luftrave dhe e fitoreve të Sk., f. 16 kënga «Skanderbeku një menatë».

82 (1958)

Samajllov, D. Starinnie albanskije, Moskë 1958. / Jepen të përkthyer në rusisht këngët: «Rrethimi i Krujës» f. 267, «Sk. dhe Ballabani» f. 269, Vdekja e Sk. f. 273.

83 (1959)

Ferrari, Giuseppe, Rapsodie e scene di vita degli Albanesi di Calabria. Cosenza 1955. / Jepen disa këngë popullore arbëreshe të periudhës para mërgimit; midis tyre edhe «Vdekja e Sk.» f. 10 e «Sk. një menatë» (Sk. e Miloshini) f. 66.

84 (1959)

Historia e Letërsisë shqipe. Pjesa e parë Folklori shqiptar. U shkrua nga *Zihni Sako*, u redaktua nga *Dhimitër S. Shuteriqi*. Tiranë 1959. / f. 60-62 flitet për legjendat e Sk., ndërsa në f. 89-93 analizohen këngët tona popullore dhe këngët popullore arbëreshe për Sk.

85 (1961)

Chansonnier populaire albanais. Introduction et presentation: Qemal Haxhihasani; version française: Kolë Luka. 1961 / f. 76-77 Jepen të përkthyer në frëngjisht këngët «Rrethimi i Krujës», «Vdekja e Sk.», «Dedë Skura», «Pjetër Shini».

86 (1961)

Mbledhës të hershëm të Folklorit shqiptar (1635-1912). Vëll. I. Redaktuar nga *Zihni Sako* (red. përgj.), *Agron Fico*, *Keti Harito*, *Qemal Haxhihasani*. Tiranë 1961 / Ribotohen në të folmen e tyre origjinale këngët arbëreshe të De Radës (për. Sk) f. 142 Trimi dhe vasha f. 165 Motra e Sk., f. 167 Sk. dhe Miloshini, f. 173 Martesa e Sk., f. 176 Sk. dhe Ballabani, f. 180 Vjehrra e keqe, f. 183 Sk. dhe vdekja, f. 188 Vdekja e Sk. .

87 (1961)

Shuteriqi, Dhimitër S., Një këngë mbi Skënderbeun. *Drita* 1961, 19 nëndor / Jepet një këngë arbëreshe për vdekjen e Sk. gjetur në dorëshkrimet e V. Dorsës.

88 (1962)

Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë. Vëll. III (1506-1839). Përgatitur nga Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra, Redaktor përgj. Prof. Aleks Buda. Tiranë 1962 / f. 127 citati nga letra e P. Budit (1621) për Viset e Sk. f. 202 citati i F. Bardhit (1637) për këngët e Sk. (shih nr. 6 e 7)

89 (1962)

Mbledhës së hershëm të Folklorit shqiptar (1635-1912) Vëll. III. Redaktuar nga Zihni Sako (red. përgj.), Qemal Haxhihasani dhe Agron Fico. Tiranë 1962. / Ribotim i materialeve të Visarit komtar (shih nr. 35) dhe i 16 gojëdhënave të revistës Albania (shih nr. 34) f. 326, 364; 496-505.

90 (1962)

Scura, Antonio, Gli Albanesi in Italia e i loro canti tradizionali. New York 1912. Ribotim fotomekanik. Cosenza 1962. / Shih nr. 36.

91 (1962)

Sokoli, Ramadan, Skanderbegu ndër kangët popullore. *Arësimi popullor*. 1962, nr. 6 f. 26-36. / Paraqiten 10 këngë e fragmente të njohura rreth Sk. Tri prej tyre shoqërohen edhe me melodinë përkatëse. Sipas aut. këto këngë ka mundësi të jenë mbeturina të një cikli të lashtë, që kanë pësuar ndryshime me shtegtimin e tyre nëpër shekuj. (Shih nr. 101)

92 (1963)

Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin e XVII. Vëll. I 1610-1634. Përgatitur nga Injac Zamputi. Tiranë 1963 / Citati i M. Bicit (1610) për të kënduarit e këngëve rreth Sk. në këtë kohë edhe në sy të turqve (f. 111) (shih nr. 4).

Citati i P. Budit (1621) për viset e Sk. (f. 301) (shih nr. 5).

93 (1963)

Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin e XVII. Vëll. II Përgatitur nga Injac Zamputi. Tiranë, 1963. / citati i F. Bardhit (1637) për të kënduarit e këngëve të Sk. në Pukë (shih nr. 7).

94 (1963)

Schmaus, Alois, Die Albanische Volksepik. Shëjzat 1963 nr. 5-8, f. 173-190. / Midis së tjerash përkrahet mendimi rreth vjetërsisë dhe origjinës popullore të disa prej këngëve arbëreshe, të ciklit të Sk. etj. Edhe në qoftë se heqim prej ciklit të këngëve arbëreshe të Sk. ndonjë këngë që mund të ngjalli ndonjë dyshim, thotë aut., prapë mbeten në këtë cikël këngë që së bashku me ele-

mente të tjera të epikës historike arbëreshe nuk kishin se si të lindnin në atdhenë e ri pas emigrimit. Për vjetërsinë e këtyre këngëve flasin edhe stili, elementet e veçanta leksikore etj.

95 (1963)

Schmaus, Alois, Relikte der Skanderbeg-Epik in der Volksdichtung der Italoalbaner. München 1963 f. 231-242 / Ekstrakt nga vëll. Märchen Mythos, Dichtung Festschrift zum 90 Geburtstag Friedrich von der Leyens am 19 August 1963 / Problemi i këngëve popullore të Sk. trajtohet tërthorazi. Më tepër flitet për karakterin dhe kuptimin e këngëve popullore epike të Arbëreshëve të Italisë në përgjithësi; për kushtet në të cilat u ruajtën këto këngë; për pikat e tyre të përbashkëta me këngët bullgare të hajdutëve dhe me këngët kleftë të grekëve. Sllavizmat bular, grazhd, kjuç, prak, bëgat; toni i ëmbël me të cilin i drejtohen personazhet njeri-tjetrit; trishja e elementeve kalë, shpatë, lautë; atmosfera sociale dhe motivet e disa këngëve; ndërtimi i tyre artistik, të sjellin ndërmend, sipas autorit, epikën e hershme të Ballkanit, sidomos atë serbokroate e bullgare. Këto elemente dëshmojnë njëkohësisht edhe për vjetërsinë paraturke të këngëve popullore epike arbëreshe.

96 (1963)

Shuteriqi, Dhimitër S., Këngët arbëreshe mbi Skënderbeun. *Mësuesi* II, 1963, nr. 3 / Autori këthehet edhe një herë në tezën e rrahur prej tij rreth origjinës së këngëve popullore për Sk. (shih nr. 69). Pasi analizon materialet e reja, arrin në përfundimet:

a) Këngët mbi Sk. tek Arbëreshët e Italisë u zhdukën me kohë; b) Këngët u krijuan gjatë shek. XVIII ose XIX jo më herët se viti 1707, kur vdiq M. Belushi dhe jo më vonë se viti 1866, kur i botoi De Rada. Po ka shumë të ngjarë që ato të jenë krijuar pas vitit 1831, kur, sipas Didier-it, tek arbëreshët e Kalabrisë, nuk kishte këngë për Sk. Një pjesë e tyre njihet më 1840, pra u krijuan para kësaj date: këngët Sk. dhe Miloshini, Sk. dhe Ballabani, Motra e Sk., Sk. dhe vdekja, Vdekja e Sk. (e pabotuar) si edhe një këngë mësalle. Po të pranojmë se edhe Bazileja mund të jetë ndër autorët e tyre... këto këngë u krijuan midis viteve 1831-34-40. Autorë duhet të jenë Dorsa, Bazile, De Rada, Santori. c) Këngët u krijuan në bazë të epikës ekzistuese dhe veprave të shtypura (Biemi, Vreto Papadhopulli).

97 (1964)

Barleti, Marin, Historia e Skënderbeut përkthyer nga Stefan J. Prifti. Tiranë 1964. / Shih nr. 1.

98 (1964)

De Rada, Girolamo, Rapsodie d'un poema albanese. Firenze, 1866 Ribotim fotomekanik. Cosenza 1964. / (Shih nr. 17)

99 (1964)

Miccoli, Giuseppe, Roccaforzata nell'Albania Tarantina. Studi e ricerche. Locorotondo 1964. / Në kap. ku flitet për folklorin (f. 288-301) trajtohen, midis së tjerash, edhe këngët për Sk.

100 (1964)

Këngë popullore. Redaktuar nga Eftim Dheri, Mexhit Daiu, Qemal Haxhihasani. Tiranë 1964 / f. 91, 99 teksti dhe melodia e këngës «Skanderbegu me ushtrinë e vet-e».

101 (1964)

Sako, Zihni, Rreth dy këngëve popullore për Skënderbenë. *Drita*, 1964, nr. 40 (4 tetor). / Nevoja e një metodologjie shkencore në kërkimet folkloristike. Këngët «O Skanderbeg oni o tej qofsh bekue» dhe «Do t'u themi një kangë vetë» botuar nga R. Sokoli (shih nr. 91) nuk paraqiten si elemente organike të një cikli popullor për Sk.

102 (1966)

Folklor shqiptar II. Epika legjendare (Cikli i kreshnikëve) Vëll. I. Redaktimi i teksteve, fjalori dhe shënimet nga Qemal Haxhihasani. Redaktor përgjigjës *Zihni Sako*. Tiranë 1966. / f. 20 krahasohet forca e jashtëzakonshme e shpatës së heroit të këngëve të kreshnikëve, Mujit, me atë të shpatës së Sk.

103 (1967)

Anamali, Skënder, Aty ku legjenda përkon me historinë. *Drita*, 1967, nr. 28 (9 korrik) / Gojëdhanat që tregohen për Sk. lidhur me kalanë e Varoshit a Qytetin e Sk. përkojnë me të dhënat e Barletit rreth kalasë së Stelushit. Gërmimet arkeologjike dëshmojnë se kalaja e Varoshit në mesjetë nuk ka qenë vetëm një kala e fortë, por edhe një qendër e rëndësishme ekonomike.

104 (1967)

Anamali, Skënder, Kështjellat shqiptare që lidhen me Skënderbeun. *Ylli* 1967, nr. 7 f. 18-20 / Mbi ruajtjen në traditën gojore të emrit të Sk. në rrenojet e një kështjelle në kufirin verior të Matit që mund të identifikohet me Stelushin e Barletit; Sofra e Sk. a Maja e Golemit në Gurin e Pishkashit; kala të Sk. në Rrajcë të Librazhdit dhe në Shëngjin të Tiranës.

105 (1967)

Fico, Agron, Figura e Skënderbeut në epikën popullore historike. *Nëndori* 1967, nr. 6 f. 129-143. / Jepet një kuadër i gjerë i këngëve popullore shqiptare dhe arbëreshe rreth Sk. Si përmenden dëshmitë historike, që flasin për ekzistencën e këtyre këngëve, bëhet paraqitja e përmbajtjes së tyre, lidhur edhe me faktet historike, si edhe komentohet vlera ideoartistike përkatëse.

106 (1967)

Fico, Agron, Populli i këndon heroit legjendar. *Bashkimi* 1967, nr. 43 (19 shkurt) / Ruajtja e kujtimit të Sk. dhe të luftërave të tij në këngët popullore.

107 (1967)

Fico, Agron, Skënderbeu në poezinë popullore. *Zëri i popullit* 1967, nr. 158 (2 ko-

rriku). / Këngët popullore të Sk. pasqyrim artistik i ngjarjeve të periudhës së heroit dhe interpretim i tyre nga pozita popullore.

108 (1967)

Haxhihasani, Qemal, Patriotizmi i grave në periudhën e Skënderbeut sipas tregimeve popullore. *Shqiptarja e re*. 1967, nr. 9 f. 22 / Patriotizmi i grave shqiptare në periudhën e Sk. sipas tregimeve popullore për Mamicën, gratë e Lurës etj.

109 (1967)

Liperi, Dhosi, Vdekja e Skënderbeut sipas legjendave popullore. *Ylli* 1967, nr. 2 f. 12, 13. / Botohen 4 legjenda (Tefterët, Armët tokës amanet, këshilla e mrame, Zija) rreth vdekjes së Sk.

110 (1967)

Sako Zihni, Figura e Skënderbeut në traditën popullore. *Luftëtari* 1967, nr. / Virtytet morale e luftarake të popullit tonë, që mishërohen në tregimet popullore rreth Sk.

111 (1967)

Sako, Zihni, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe tradita gojore për të. *Zëri i Popullit* 1967, nr. 218 (10 shtator). / Vështrim i përgjithshëm i përhapjes, tematikës dhe rëndësisë së traditës gojore rreth Sk. Vlerësimi i saj nga Partia e Punës.

112 (1967)

Sokoli, Ramadan, Figura e Skënderbeut në folklorin tonë dramatik. *Drita* 1967, nr. 42 (15 tetor) / Lindja e disa çfaqjeve me karakter dramatik rreth figurës së Sk. te Arbëreshët e Italisë. Jepet një përkthim i hollësishëm i E. Xhordanos për zakonet që ruhen në Frashnitë lidhur me këto çfaqje (shih nr. 81).

113 (1967)

Zajmi, Abdulla, Skënderbeu në poezinë tonë popullore. *Jeta e re* (Prishtinë) 1967, nr. 1 f. 93-103.

114 (1967)

Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun. Pregatitur nga Qemal Haxhihasani. Redaktor përgjegjës Zihni Sako. Tiranë 1967, f. 280. / Në pjesën e parë të këtij vëllimi që mund të quhet përmbledhja më e gjerë dhe më autentike e traditës popullore të krijuar rreth heroit tonë kombëtar, jepen 747 gojëdhëna a tregime, të mbledhura kryesisht pas çlirimit. Tregimet janë grupuar sipas tematikës në këto kapituj: 1) Kastriotët 2) Lindja e Sk. 3) Rinia 4) Të dhëna për shtetin e Sk. dhe qeverimin e tij 5) Kalatë 6) Luftat 7) Armët 8) Patriotizmi popullor 9) Vetitë fizikomorale të Sk. 10) Toponime me emrin e heroit 11) Thënie të Sk. 12) Banesa — Familja 13) Bashkëkohës të Sk. 14) Vdekja e Sk. Në pjesën e dytë janë paraqitur 25 këngë të vendit tonë, prej atyre më të hershmeve deri në ditët e sotme (duke përfshirë edhe ndonjë këngë që nuk flet drejtpërsëdrejti për Sk., por që gërshetohet në to emri

i heroit) dhe 17 këngë arbëreshe në të folmen e tyre origjinale dhe të këthyera në të folmen e sotme (8 këngët e njohura të De Radës dhe 9 këngë të tjera, që flasin për ngjarje të kësaj periudhe: k. e Dedë Skurës, Pal Golemit, Nik Petës etj.)

Në hyrje f. 5-17 janë trajtuar probleme të traditës popullore rreth Sk., Origjina e saj, ruajtja përmes shekujve, historiku i mbledhjes dhe i botimit të tregimeve dhe këngëve popullore, përmbajtja dhe vlera ideoartistike e tyre.

INDEKSI I AUTORËVET

- Anamali, S. 103, 104
 Bardhi, F. 6, 7, 80
 Barleti, M., 1, 97
 Bellusch, F. 44
 Biemmi, G. 9
 Bilotta, B. 37
 Bizzi, M. 4
 Blakçori, J. 51
 Bota Shqiptare, 65
 Boué, A. 13
 Buda, A. 88
 Budi, P. 5
 Ceka, H. 71
 Çelebia, E. 8
 Degrand, A. 32
 De Grazia, D. 26
 De Rada, G. 17, 25, 98
 Didier, Ch. 12
 D'Istria, D. 18
 Dorsa, V. 15
 Draganov, P. 28
 Erdelanovic, J. 45
 Ferrari, G. 83
 Fico, A. 86, 89, 105, 106, 107
 Folklorë II 62
 Franco, D. 3
 Giordano, E. 81
 Gjeçovi, Sh. (Lkeni i Hasit) 34, 89
 Gjelaç, F. 56
 Hahn, J.G. 19, 20
 Harapi, Z.M. 54
 Harito, K. 86
 Hatry, M. 11
 Haxhihasani, Q. 78, 85, 86, 89, 100, 102, 108, 114.
 Jorga, N. 40
 Ippen, Th. 31
 Jovanoviç, T. i V. 48
 Kodra, Z. 72, 74, 79.
 Kopështi letrar 39
 Kormaku, V. 58
 Lambertz, M. 33
 Liperi, Dh. 63, 109
 Luka, K. 85
 Miccoli, G. 99
 Mitko 6, 23
 Naçi S. 88
 Nazione Alban. 30
 Noli, F. 42
 Pall, F. 59
 Petrota, R. 64
 Pouqueville, F. C. H. L. 10
 Prennushi, V. 35, 89
 Rugiero, G. 22
 Sabellici, M.A. 2
 Sako, Z. 68, 77, 78, 84, 86, 89, 101, 102, 110, 111, 114.
 Schmaus, A. 94, 95
 Seura, A. 36, 90
 Sevari, 66
 Sirdani, M. 41, 47, 52, 53
 Smilari, A. 27
 Sokoli, R. 91, 112
 Staffa, F. 14
 Stratico, A. 29
 Suflay, M. 43, 46
 Shkodra, Z. 88
 Shuteriqi, Dh. S. 69, 70, 75, 84, 87, 96
 Taipi K. 55
 Tajani, F. 24.
 Tozer, H. F. 21
 Varfi, A. 76
 Visaret e kombit I 57, XIII 67
 Zajmi, A. 113
 Zamputi, I. 88, 92, 93
 Zharri, Sh. 60